

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune për personel akademik me kohë të plotë i kategorisë Asistent-lektor në Departamentin e Prodhim-Menaxhimit, Grupi Mësimor Shkencor i Menaxhimit Industrial dhe Inxhinierisë Ekonomike për lëndët:

1. *Kontabilitet kosto*
2. *Analiza e pasqyrave financiare*

Kandidatët që do të konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të ketë diplomë të ciklit të dytë në Inxhinieri Ekonomike.
2. Të ketë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të dy cikleve apo të ciklit të integruar jo më pak se 80/100.
3. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë profesionale dhe/ose akademike.
4. Të zotërojë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **22.11.2019** pranë Zyrës së Protokollit në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
4. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
5. Kopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Certifikatë kualifikimi dhe trajnimesh te ndryshme (ne rast se ka);
7. Dëshmi e gjuhës e noterizuar;
8. Raport mjekësor për aftësi në punë;
9. Formular vetë deklarimi.